



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

SYLLABUS i Lëndës Financa të korporatave

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Financa të korporatave
Niveli:	Bachelor
Status i lëndës:	Obligative
Vitii studimeve:	II (semestri IV)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	FB
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrim i lëndës	Financat e korporatave përfshin financat e bizneseve të mëdha-korporatave, si biznese specifike dhe të organizuara si shoqëri aksionare..
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës "Financat e Korporateve" është të studiojë në thellësi shumë aspekte të menaxhimit financiar të korporatave, trajtimi i lëndës ka për qëllim të vendosë studentët në pozitën e menaxherit financiar për të kuptuar qartë marrjen e vendimeve financiare dhe investive. Analiza teorike dhe procedurale ka për qëllim të bëjë të qartë format e maksimizimit të vlerës së korporatës për të rritur përfitimet e aksionerëve. Kujdes i vecantë do të kushtohet fushës së investimeve, politikës së dividendës, strukturës së kapitalit dhe menaxhimit të aseteve të firmës.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studentët duhet të jenë në gjendje të kuptojnë se financat janë fushë kyce në suksesin e biznesit, studentët do të përfitojnë aftësi të aplikojnë shkathtësitë kuantitative në funksion të zgjidhjes së problemeve financiare. Pas përfundimit të kursit studentët do të jenë në gjendje të identifikojnë dhe shpjegojnë marrdhënjet në mes variablave kryesore financiare ata gjithashtu do të jenë në gjendje të rekomandojnë për llojin dhe sasinë e financimit që ka nevojë firma

	duke gjetur format më të mira të financimit dhe kanalizimin e tyre drejt investimeve në formën më optimale të mundshme.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata, Kolokvium	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Detyra shtëpie	1	5	5
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	1	3	3
Koha e studimit vetanak të studentit	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Përgaditja përfundimtare për provim	5	4	20
Totali			125
Metodologjia e mësimëdhënies:			
- Mënyra e të mësuarit do të jetë përmes ligjëratave dhe ushtrimeve(me studime rasti dhe me punime seminarike do të realizohen ushtrimet). - Mësimi do të zhvillohet në grupe. Për çdo segment të një ligjëratë përgatitet prezantimi edhe në sllajdeku u prezantohet studentëve rregullat, principet themelore të njësisë mësimore. - Në çdo pjesë të ligjëratës përkatëse studentët aktivizohen me komente, pyetje dhe sqarime plotësuese si rezultat të pyetjeve. - Studentët kanë komoditet që të komentojnë, pyesin dhe të sqarojnë dilemat dhe paqartësitë eventuale, gjithnjë me një rend dhe disipline adekuate. - Një ditë në javë, pra pas përfundimit të mësimit mbaj konsultime me studentët edhe pse studentët e gëzojnë të drejtën e komunikimit përmes postës elektronike.. - Në ushtrime, krahas zgjidhjes së detyrave nga lënda mësimore, do të zhvillohen diskutime për problemet e ndryshme financiare globale, rajonale apo vendore si dhe zgjidhja e këtyre problemeve.			

Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i studentëve do të bëhet në bazë: ✓ Të vijueshmërisë dhe angazhimit të tyre, ✓ detyrave me shkrim ✓ suksesit në kollokviume si dhe ✓ provimit përfundimtar.
Literatura	
Literatura bazë:	Prof.dr.Bedri Statovci, dr.Shefket Jakupi, Msc.Vlora Berisha“ Financat e korporatve“,Ulqin 2017
Literatura shtesë:	“Principles of corporate finance” Richard Braely,Steëart Mayers,Franklin Allen,2011 Prof.Dr.Gazmend Luboteni, Financat e Korporateve, Prishtinë, 2007 S. Ross, R. Westerfield and J. Jaffe, Corporate Finance, 9th Edition, McGraw-hill Irwin, 2012.
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Prezantimi i Syllabusit
Java e dytë:	Hyrje Sistemi Financiar dhe Ekonomia Institucionet Financiare
Java e tretë:	Afarizmi i Bankave Raportet Financiare Tatimet
Java e katërt:	Rrjedha e Parave (Cash Floë)
Java e pestë:	Vlera ne kohe e parase
Java e gjashtë:	Rreziku dhe Kthimi Buxhetimi i Kapitalit
Java e shtatë:	Kolokviumi i Parë
Java e tetë:	Vendimet Financiare dhe Efikasiteti i Tregut Politika e Dividentës Dhe Struktura e Kapitalit
Java e nëntë:	Leverixhi dhe Struktura e Kapitalit Opcionet

Java e dhjetë:	Menaxhimi i Rrezikut Financimi Përmes Borxhit
Java e njëmbëdhjetë:	Determinimi i Normave Të Kamatës Në Treg Struktura e Rrezikut Të Normave Të Kamatës Teoria e Alokimit Të Portfolios
Java e dymbëdhjetë:	Planifikimi Financiar
Java e trembëdhjetë:	Menaxhmenti Financiar Afatshkurtër Menaxhimi i Kredive
Java e katërbëdhjetë:	Tregu I Këmbimit Valutor Dhe Norma e Këmbimit Merxherët Dhe Akvizicionet
Java e pesëmbëdhjetë:	Kolokviumi i Dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<i>Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë përbligim që pas çdo ligjërata të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët nuk janë të obliguar të nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit. Studentët inkurajohen të përcjellin diskutimet në media dhe të hapin diskutim elidhur me to. Student iduhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në ligjerata. Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe të kniktëpunimit.</i>